



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHETËTOR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizorit

Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizorit:

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë për vitin 2020.

Qëllimi i revizionit:

Të fitohet bindje e arsyeshme nëse raportet financiare janë të lira nga paraqitjet e gabuara materialisht, dhe nëse aktivitetet dhe transaksionet janë në pajtim me rregullativën ligjore.

Gjendjet kyçe të konstatuara:

Për një pjesë të objekteve të trashëguara nga subjekti paraardhës juridik i partisë nuk është zgjidhur statusi i pronësisë dhe të njëjtit nuk janë regjistruar në evidencë.

Mjetet për anëtarësim nga çdo organizatë komunale, në total paguhet drejtpërdrejt në llogarinë e transaksionit, për këtë arsye nuk ofrohet një pasqyrë e plotë dhe konfirmim i anëtarësimit të paguar individualisht.

Mendimi i dhënë/përfundimi*:

Shprehëm mendim me rezervë në lidhje me paraqitjen e të vërtetës dhe objektivitetit të raporteve financiare dhe për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante, udhëzimet dhe politikat e vendosura.

Rekomandimet kyçe:

Vazhdimi me aktivitetet për të përcaktuar pronësinë e objekteve të cilat shfrytëzohen dhe evidentimi i tyre.

Rregullimi i mënyrës së njoftimit, grumbullimit dhe pagesës për shumat individuale të mjeteve në bazë të anëtarësimit.

Dobësitë kyçe të sistemit:

Të rishikohet dispozita ligjore në pjesën e financimit të fushatës zgjedhore me mjete nga llogaria e rregullt; saktësimi në pjesën e donacioneve nga partia politike, në lidhje me limitet individuale dhe totalit të mjeteve, ndryshimi dhe plotësimi i akteve nënligjore me të cilën rregullohet mënyra e mbajtjes së kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse dhe rregullimin e mënyrës së pagesës dhe evidentimit të anëtarësisë si burim i financimit.

Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Janë marrë vërejtje të draft-raportit të revizorit të autorizuar shtetëror gjatë të cilës është vlerësuar se të njëjti paraqesin njoftime.

Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

Përgjigja e vërejtjeve është dhënë në bashkëngjitje të këtij raporti përfundimtar.

*



pozitive



me rezervë



të pavolitshëm



të përmbajtur